Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	**27.11.2023**	**04.12.2023**	**2023/0906**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.11.2023, OE "N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0906, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE Grupi i Operatoreve Ekonomik "D & T Group" SH.P.K; Kosova Motors" J.S.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me pajisje per pastrimin e kryeqytetit", me nr. të prokurimit: "616-23-7016-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 1,500,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0906 i dt: 14.11.2023, Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ne konsiderojm qe AK ka shkelur dispozitat ligjore ne keto nene:

Neni 1: Qellimi

Neni 59: Ekzaminimi, Vleresimi dhe krahasimi I tendereve

Neni 60: Kriteret per dhenien e kontrates.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne konsiderojm qe AK-ja gjate ekzaminimin, vleresimit dhe krahasimit te tendereve nuk ka

ekzaminuar mir operatorin e propozuar per kontrat ngase ne qasje te kerkuar te dokumentave verehen shkelje si dhe mosperputhje ne dokumentat e ofertuara dhe atyre te cilat jan publike te webfaqet e prodhuesve. Ne kemi evidentuar shkelje ne pikat e poshteshkruara.

1.Valdrin Manaj – personi pa autorizuar per nenshkrim te deklarates nen betim si dhe marrveshjes se bashkpunimit.

Ne baze te interpretimit te KRPP-se te pyetja Nr. 40 (te pyetjet e shpeshta), citat: 40. Si te veprohet ne rastet kur dosja e tenderit, perfshire deklaratat nen betim dhe dokumentat tjera te dosjes se tenderit nenshkruhen ne emer te Operatorit Ekonomik ofertues, nga nje person I pa autorizuar? Konform nenit 87, paragrafi 2, nen-paragrafit 2.7 te Ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurim Publik, I ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa I perket qeshtjes se parashtruar me lart, KRPP ofron interpretim ligjor si ne vijim: Te drejten e nenshkrimit nga nje person ne emer ten je personi tjeter ne dosjen e tenderit dhe deklaratat nen betim pa nje autorizim nga personi kompetent, nuk e rregulloj Ligji per Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytesor I prokurimit public. Megjithate, per derisa ne Formularet standard te dosjes se tenderit perfshire deklaraten nen betim dhe dokumentat tjera, kerkohen te dhenat mbi identifikimi e OE, (sic jane: Emri dhe mbiemri, pozita, nenshkrimi, data dhe vula etj) pra kerkohet te plotesohen dhe te nenshkruhen nga perfaqesuesi I Operatorit Ekonomik (dhe jo nga nje person qe nuk eshte kompent dhe nuk ka autorizim per ta bere nje gje te tille). KRPP, konsideron se nenshkrimi "per: ne emer te perfaqesuesit te OE nga nje person qe nuk ka autorizim per nje gje te tille, nuk mund te jete I pranueshem.?

Andaj duke u bazuar ne kete interpretim te lartepermendur nga KRPP-ja, si dhe mos deshmia e dokumentit qe personi I lartpermendur eshte I autorizuar nga kompania dhe dokumenti te jet I noterizuar per nenshkrim marrveshjes, dhe I Deklarates nen betim, ateher AK-ja eshte dashur ta trajtoj personin ne fjale si te paautorizuar dhe oferta duhej te cilesohet si e papergjegjshme. -Ne kerkesen tone per rishqyrtim Ak-ja nuk eshte pergjigjur rreth kesaj qeshtje e as ne qasje ne dokumenta nuk eshte deshmuar se personi ne fjale ka autorizim per nenshkrimin e deklarates nen betim dhe marrveshjeve tjera, per me teper personi nuk figuron si person I autorizuar ne informatorin e biznesit dhe ne website zyrtar te ARBK-se. Andaj ne konsiderojm qe nenshkrimi I tij ne deklarate nen betim dhe ne marrveshjet te tjera si I paautorizuar do duhet nga AK-ja ta cilesohet si te prapranueshme dhe oferten e nga ky grup ta cilesoj si te papranueshme.

2. Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 4, citoj: OE duhet te dorezoj nje autorizm apo konfirmim I prodhuesit te superstruktures, Deshmit e kerkuara: Autorizimi qe permban sherbimet e dizajnimit, zhvillimit, prodhimit, shitjes dhe sherbimi pas shitjes te automjeteve dhe pajisjeve komunale, operatori I propozuar per kontrat ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi ne te cilen e autorizon vetem per ofertim, negocim dhe dhenie te ofertes ndersa nuk e autorizon per sherbimet e dizajnimit dhe sherbimi pas shitjes te automjeteve dhe pajisjeve komunale.

-Ne pergjigjen e AK-se permend faktin qe autorizim I referohet aktiviteti perkates dhe se ne nuk e kontestojm ate por ne kerkesen e AK-se ne dosje te tenderit eshte kerkuar qe perveq autorizimit per shitje, negocimi dhe ofertimit autorizimi ne vete duhet te permbajt edhe sherbimet e dizajnimit dhe sherbimet pas shitjes. Me rendesi te posaqme eshte sherbimi pas shitjes ngase kamionat ne fjale se bashku me superstrukturen e tyre do ken nevoj edhe per servisim dhe mirembajtje, ku pjeset qe do riparohen dhe mirembahen duhet te jene origjinale

nga prodhuesi. Ne autorizimin ne fjale nuk e ka edhe sherbimin pas shitjes. AK-ja perkatshisht komisioni vleresues nuk e ka ekzaminuar dhe vleresuar ne detaje autorizimin e deshmuar me kerkesen e vet AK-se ne dosje te tenderit.

3.Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 5, citoj: OE duhet te dorezoj nje vertetim te karakteristikave teknike te kerkuara te superstrukes – Deshmi: Vertetim I firmosur dhe vulosur nga prodhuesi I superstruktures, me numer te prokurimit publik dhe modelit te superstruktures se ofruar – operatori I propozuar per kontrat nuk ka e saktesuar modelin e superstruktures me te cilen oferton. -Ne pergjigjen e AK-se ne kerkesen ton per rishqyrtim AK thot qe vertetimi eshte ne pajtim te plote me kerkesen perkatese te dosjes se tenderit. Ky fakt nuk qendron ngase Operatori I propozuar per kontrate ne vertetimin e prodhuesit per superstruktur askund nuk vertetohet/shkruhet modeli I superstruktures me te cilen ky OE oferton ne kete aktivitet prokurimit. Andaj edhe ne kete pike AK nuk e ka ekzaminuar vertetimet sipas kerkeses se vet te AK-se ne dosje te tenderit.

4.Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 8, citoj: OE duhet te dorezoj nje certifikat te vlefshme per testimin e kualifikimit te saldatorve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017 ose standardit kombtar ekuivalent, per te pakten 5 saldator te punesuar nga prodhuesit e superstrukturave me deshmi punesimi – ne qasje ne dokumentat te kerkuar ne AK si dhe ofrimit te tyre verejm se operatori I propozuar per kontrat ka ofruar certifikatat e kualifikimit te saldatorve sipas standardit te kerkuar por asnjeri nga ata nuk e ka certifikaten e vleshme, pra jan me validitet te skaduar.

-Per kete pike ne kemi kerkuar qasje te plote ne dokumentat per tenderuesin te propozuar mper kontrate me daten: 27.10.2023. AK-ja nuk I eshte pergjigjur emailit tone, por mbas thirrjes tone ne telefon me daten 30.10.2023 zyrtaret komunal na jane pergjigjur "zyrtari qe eshte i ngarkun me kete lend eshte ne pushim mjeksor, emailin nuk e kemi pa por hajde kur te duash ne zyre 1214". Po te llogariten afatet kohore per kerkes rishqyrtim I bie qe data 30.10.2023 eshte dita e 3. Vlen te theksohet se AK-ja ka qen rezistuese ne dhenien e dokumenta me arsyetim se operatori ekonomik ka shfrytezuar ligjin e prokurimit publik dhe ka kerkuar nga AK-ja qe dokumentat (vleresuese shume te rendesishme) te i cilesoj si sekret afarist. Ne kerkesen per rishqyrtim e kemi bere me daten 31.10.2023 (dita e 4) per dokumentat te cilat AK-ja na I kane dhene per operatorin e propozuar per kontrate. Ne kemi verejtur qe ne dokumentat e ofruara mungojn kerkesat e AK-se drejtuar ketij operatori ekonomik permes formularit per sqarimet te tenderi dmth kane munguar Vertetim I ATK-se, Vertetim Gjykate per ndonje drejtues, menaxher ose drejtor qe nuk jane shpallur fajtor ne dhjete vitet e fundit ne ndonjeren prej gjykatave, si dhe vertetimi I gjykates qe kompania nuk eshte ne falimentim. Andaj ne me daten 31.10.2023 kemi bere nje email te dyte drejt AK-se ku kemi kerkuar qe te na ofrohen te gjithat dokumentat dhe kerkesat e AK-se me OE te propozuar per AK. Ak-ja eshte pergjigjur pozitivisht (edhe pse eshte dashur te na jepen te gjitha dokumentat qe ne takimin e pare) por kur ne kemi shkuar ne zyret e AK-se na eshte transmetuar qe puna me pale tek ata eshte deri 15:00 dhe nuk mund te ofrohen dokumentat, por mund ti merrni diten e neserme dmth 01.11.2023. Duke pare qe distancat ndermjet qyteteve dhe afatit kohor per ankese, ne kemi vendosur qe ankesen ta bazojm me dokumentat e dhena (pa ato bisedat ndermjet AK-se dhe OE). E ne ato dokumentat te gjitha certifikatat te prezentuar kan qen me skadenc, por ne dokumentat te siguruar diten e 5 (diten e fundit per ankese) verejm qe perveq dokumentat qe kerkohen para shpalljes se njoftimit per shperblim me kontrate AK-ja ka

kerkuar edhe per certifikat te cilat OE I ka dhene te tjera por me afat. Nga mos ofrimi I te gjitha dokumentave dhe afatit te shkurter per ankes ne kerkesen per rishqyrtim tek AK e kemi bazuar ne dokumentat fillestare te dhene nga AK-ja.

4.Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 13, citoj: OE duhet te dorezoj katalogun e shasis, deshmi: Katalogu I nenshkruar dhe vulosur; Per shasin e ofertuar te brendit ATLAS Ne website zyrtare te kompanis per te cilen operatori I propozuar per kontrat ka autorizim per ofertim per kete tender, modeli I ofertuar eshte me specifikat te ndryshme nga ato per te cilen jane bashkangjitur ne dosjen e ketij tenderi (https://commercial.otokar.com.tr/OtokarTicari/media/Otokar-Ticari/kamyon/atlas-

3d/ATLAS-2023-(8,5t-12t)-ok-montaj-EN-(Avrupa)-TK04EE-23-onizleme-(1)_1.pdf)

Pra shihet diferenca e specifikave ne keto raste:

Wheelbase – ne katalog eshte: 3400mm ndersa ne website eshte 3360mm Technically permissible maximum mass on front axle – ne katalog eshte: 4000kg ndersa ne website eshte 3000kg Technically permissible maximum mass on rear axle - ne katalog eshte:7500kg ndersa ne website eshte 6000kg Engine type - ne katalog eshte: Diesel Euro6 SCR Particular Filter EGR ndersa ne website eshte Cummins Intercooler Turbo Diesel Euro6 Engine Displacement - ne katalog eshte: 5020cm3 ndersa ne website eshte 3800 cm3 Max. Net Power - ne katalog eshte: 150kw @2600rpm ndersa ne website eshte 112 kW @ 2600 rpm Max. Net Torque - ne katalog eshte: 800Nm ndersa ne website eshte : 534 Nm Fron Suspension - ne katalog eshte: Layered parabolic suspension ndersa ne website eshte : Leaf spring Fuel Tank capacity - ne katalog eshte: 200plastic ndersa ne website eshte : 120litra Dicital Tacograph – ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till Double diagonal shape daytime running - ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till Warning signal 0 backward driving white color ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till High air absorption ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till PTO –Speed mechanism - ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till Chassis thickness frame 6mm - ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till Automatic regeneration of automatic - ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till DPF filter white driving ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till Chassie thickness frame 6mm ne katalog e dhenen nga ky operator ekonomik eshte I shkruar ndersa ne website nuk thot qe ka nje gje te till Diferencat e tilla ndermjet katalogut te ofruar dhe websitit zyrtar te kompanis bien ndesh ndermjet vetit.

-Ak-ja ne pergjigjen e kerkeses per rishqyrtim thote qe jane analizuar katalogjet me tem cilat ka ofertuar tenderuesi I rekomanduar me dosjen e tenderit, dhe se komisioni vleresues nuk ka gjetur mosperputhje ndermjet katalogjeve dhe dosjes se tenderit. Ne fakt AK-ja dhe komisioni vleresues nuk e ka lexuar/kuptuar kerkesen ton per rishqyrtim. Ne kemi treguar fakte ku ka mosperputhje ndermjet katalogut te prezentuar nga OE I propozuar per kontrate dhe katalogut

te kompanis prodhuese ATLAS per te cilen ky operator ka prezentuar autorizimin e jo ndermjet katalogut prezentuar dhe dosjes se tenderit. Nuk eshte e mundur qe kompania prodhuese te prezentoj katalog tjeter ne website zyrtar te tyre dhe tjeter te jepet per tenderin ne fjale. Katalogu I prezentuar nga ky OE eshte I riperpunuar dhe pershtatur dosjes se tenderit. AK-ja eshte dashur gjate vlersimit te tenderave dhe mbas kerkeses son per rishqyrtim te kerkoj se paku nga OE nje vertetim nga prodhuesi te nenshkruar dhe vulosur se katalogu I ofertuar nga OE eshte I prodhuesit dhe nuk eshte I perpunuar/falsifikuar.

5. Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 13, citoj: OE duhet te dorezoj katalogun e shasis, deshmi: Katalogu I nenshkruar dhe vulosur; Per shasin e ofertuar te brendit FORD Ne website zyrtare te kompanis, modeli I ofertuar nga ky operator ekonomik I propozuar per kontrat eshte me specifikat te ndryshme nga ato te bashkangjitur ne dosjen e ketij tenderi (https://www.fordtrucks.it/Uploads/Foy/ford_trucks_1833_dc_ero6_technical_brochure.pdf

Pra shihet diferenca Pra shihet diferenca e specifikave ne keto raste:

Emission – ne katalog e ofertuar: EURO 6SCR ndersa ne website eshte Euro 6

Wheelbase (mm) - ne katalog e ofertuar: 4300 ndersa ne website eshte 4250

Engine Type - ne katalog e ofertuar: Ecotorq 8liters – 6cyl ndersa ne website eshte

Ecotorq 9 liters

Displacement (cc) - ne katalog e ofertuar: 7974cc ndersa ne website eshte 8974cc

Power - ne katalog e ofertuar: 1655 – 2200rpm ndersa ne website eshte 1900rpm

Coolant Volume - ne katalog e ofertuar: 46L ndersa ne website eshte 35 L

Manuel Transmission / Ratios (1. gear - 9. gear) - ne katalog e ofertuar: 6 1 speed ndersa

ne website eshte 9 1 Speed

Suspension (Front/Rear) - - ne katalog e ofertuar parabolic leaf spring / air suspension – 2

air bellows ndersa ne website eshte Parabolic Leaf Spring / Multi-Leaf Spring

Axle Ratio - ne katalog e ofertuar4.11 ndersa ne website eshte 4,63

Tyres - ne katalog e 315/70 R22.5 ndersa ne website eshte 12 R 22,5

Overall Length - ne katalog e 8039mm ndersa ne website eshte 8850mm

Overall Vehicle Height - ne katalog e ofertuar 3100mm ndersa ne website eshte 3140

Rear Overhang - ne katalog e ofertuar 2300 ndersa ne website eshte 3100

Useful Chassis Length - ne katalog e ofertuar 5823 ndersa ne website eshte 6580

Diferencat e tilla ndermjet katalogut te ofruar dhe websitit zyrtar te kompanis bien ndesh ndermejt vetit.

-Edhe ne kete pike Ak-ja ne pergjigjen e kerkeses per rishqyrtim thote qe jane analizuarn katalogjet me te cilat ka ofertuar tenderuesi I rekomanduar me dosjen e tenderit, dhe se komisioni vleresues nuk ka gjetur mosperputhje ndermjet katalogjeve dhe dosjes se tenderit. Ne fakt AK-ja dhe komisioni vleresues nuk e ka lexuar/kuptuar kerkesen ton per rishqyrtim. Ne kemi treguar fakte ku ka mosperputhje ndermjet katalogut te prezentuar nga OE I propozuar per kontrate dhe katalogut te kompanis prodhuese FORD per te cilen ky operator ka prezentuar autorizimin e jo ndermjet katalogut prezentuar dhe dosjes se tenderit. Nuk eshte e mundur qe kompania prodhuese te prezentoj katalog tjeter ne website zyrtar te tyre dhe tjeter te jepet per tenderin ne fjale. Katalogu I prezentuar nga ky OE eshte I riperpunuar dhe pershtatur dosjes se tenderit. AK-ja eshte dashur gjate vlersimit te tenderave dhe mbas kerkeses son per rishqyrtim te kerkoj se paku nga OE nje vertetim nga prodhuesi te nenshkruar dhe vulosur se katalogu I ofertuar nga OE eshte I prodhuesit dhe nuk eshte I perpunuar/falsifikuar. Per me teper komisioni vleresuar nuk ka analizuar as deklaraten e prodhuesit ne kete rast te dealerit ne Shqiperi ALBANIA MOTOR COMPANY ku thuhet qe katalogu I prenzentuar nga ata per modelin (saktesuar) FORD TRUCK 1833DC(shih MANUFACTURER'S STATEMENT) eshte sipas specifikave te kerkuara ne dosje te ketij tenderi. Operatori ekonomik I propozuar per kontrate ne katalogun e ofruar e ka shtuar 2023 pjeses FORD TRUCK 1833DC pra e ka prezentuar si 2023 FORD TRUCK 1833DC per tju pershtatur dosjes se tenderit. AK-ja eshte dashur te kerkoj sqarime perse katalogu I prezentuar permend modelin tjeter ndersa prodhuesi ka dhen modelin I cili eshte edhe public!

-Mos perputhje ne katalog te prezentuar per kamionin FORD e kemi edhe ne katalogun e prezentuar nga operatori I propozuar per kontrate, ne vizatim teknike te kamionit shihet qart qe gjatesi total (OVERALL LENGTH) eshte 8100mm(faqe 3 e katalogut), ndersa ne pershkrim te specifikave teknike (faqe 4) thuhet qe OVERAL LENGTH eshte 8039mm, pra kemi mosperputhje ndermjet vizatimit dhe pershkrimit qe gje na e forcon dyshimin ton qe katalogu I prezentuar nga operatori I propozuar per kontrate eshte riperpunuar dhe pershtatur dosjes se tenderit.

-Te bashkangjitur gjeni edhe komunikimin kur pikerisht dealer nga Shqiperia per te cilen OE I propozuar per kontrat ka marr autorizim per ofertim ne kete aktivitet prokurimit ALBANIA MOTOR COMPANY ku ka kerkuar nga prodhuesi HIDROMAK (bashkpuntor I yni ne Turqi) qe per modelin ne fjale te ofertoj me superstrukt. Te bashkangjitur gjeni katalogun e modelit te kamionit te cilin e ka bashkangjitur ne email se bashku me diferencat ne specifikat teknike ndermjet dosjes se tenderit dhe modelit te kompanis FORD. Edhe ketu shihet qe modeli I kamionit eshte FORD TRUCK 1833DC e jo 2023 FORD TRUCK 1833DC. Bazuar ne keto fakte ne dyshojm qe OE I propozuar per kontrate I ka pershtatur specifikat teknike te modelit FORD TRUCK 1833DC qe te jene ne perputhje me kerkesen e AK-se ne dosje te tenderit.

Ne autorizimin e paraqitur nga operatori I propozuar per kontrat te prodhuesi FORD, shihet qe kompania prodhues FORD CEE Sales LLC e autorizon kompanin ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. me seli ne Tirane ne Republiken e Shqiperis per shitjen e makineris, pjeseve rezerv dhe aksesorve ne territorin e Shqiperis, me sakt: kompania ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. eshte importues/distributor zyrtar per territorin e Shqiperis, dmth company ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. eshte e autorizuar vetem per Republiken e Shqiperis e jo edhe per Kosove, kompania ne fjale nuk e ka te drejten e shitjes, servisimit te kompanis FORD edhe per territorin e Republikes se Kosoves. Andaj autorizimi I ofruar nga ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. operatorit te propozuar per kontate

eshte I pavleshem dhe si e till oferta nga ky operator duhet te trajtohet si e papergjegjshme. -Ak-ja ne pergjigjen te kerkeses son per rishqyrtim permend qe ne nuk kemi deshmuar prove ose argument qe distributor ne fjale nuk ka autorizim per shitjen ne Kosove. Ne fakt autorizimi ne fjale e saktezon se kompani FORD CEE Sales LLC e autorizon kompanin ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. me seli ne Tirane ne Republiken e Shqiperis per shitjen e makineris, pjeseve rezerv dhe aksesorve ne territorin e Shqiperis, autorizimi ne fjale e ka saktesuar se ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K ka te drejten e shitjes vetem ne Shqiperi e jo ne gjithe territoret ne Balkan. Nese vertetimi I volusur dhe I nenshkruar me permbajtje te sakt te cituar se autorizimi vlene vetem per territorin e Shqiperis nuk I ka mjaftuar AK-se ose komisionit vleresues te njejtit kane mundur te kerkojn nga kompania FORD CEE Sales LLC rreth ketij autorizimi e jo te kerkojn nga operator ekonomik fakte, kur dihet qe ligjet mundsojn AK-te te kerkojn saktsin e dokumentave e jo operator ekonomik.

-Per me teper komisioni vleresues nuk ka ekzaminuar dokumentat autorizuese te prezentuara nga ky operator ekonomik. Eshte shum e kjart e shikueshme tek autorizimi dhe deklarata e prodhuesit te leshuar nga ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K falsifikimi I vules se kompanis si dhe I nenshkrimit te personit GENTIAN KARAJ. Verehet origjinaliteti I nenshkrimit tek autorizimi ndersa tek MANUFACTURE'S STATEMENT dhe WARRANTY STATEMENT shihet qe nenshkrimi I te njejti person eshte I ndryshem. Si eshte e mundur qe dy nenshkrime te jete te ndryshme nga I njejti person!? Ne dyshojm se Operatori ekonomik I propozuar per kontrate ka bere falsifikim te dokumentave per me teper ka nderhy edhe ne dokumentat te prodhuesve apo te personave tjer, dhe si I till duhet qe oferta e tij te cilesohet e papergjegjshme. Ne autorizimin e paraqitur nga operatori I propozuar per kontrat te prodhuesi FORD, shihet qe kompania prodhues FORD CEE Sales LLC e autorizon kompanin.

6. Ne qasjen ne dokumentat zyrtare per operatorin e propozuar per kontrate nuk jane ofruar te gjitha dokumentat qe ky operator ekonomik ka patur/derguar tek AK-ja. Neve na eshte ofruar vetem dokumentat qe jan pjese ne aplikim ndersa komunikimet tjera qe AK-ja I ka patur me kete OE nuk jane te dhene. Ato jan dorzuar tek ne mbas shum asistemeve tona (shih pika 4 te ankeses). Aty kemi verejtur se mungojn dokumentat qe dorezohen para njoftimit per shperblim me kontrate si dhe kerkesat e AK-se ne sqarime shtese per te cilen AK-ja lenden e ka rikthyer ne rivleresim mbas ankeses pikerisht te ketij operatori ekonomik. -Sikurse eshte permendur me lart mbas shum asistimeve tona AK-ja ne diten e fundit per kerkese per rishqyrtim ka ofruar te gjitha dokumentat te ketij operatori ekonomik. Ne ato dokumentave kemi verrejtur qe nuk eshte deshmuar vertetim gjykate per dretor, drejtues apo menaxher perkatsisht: ne kerkesen e pershtatshmeris pika 2 kerkohet: .Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale, per kompanin KOSOVO MOTORS J.S.C. SH.A. eshte ofruar vertetim gjykate te personit Nehat Hoxha, ky person ne ARBK figuron si person I autorizuar dhe ne informator si agjent I rregjistruar, e askund nuk thot qe eshte drejtor, menaxher ose ndonje nga pozitat drejtuese andaj kemi mosperputhje midis kerkeses se AK-se ne dosje te tenderit dhe ofrimit. AK-ja perkatsisht komisioni vleresues nuk eshte dashur ta pranoj si te sakt kete deshmi por te kerkoj vertetimin e gjykates sipas kerkeses se tyre ne dosje te tenderit, vertetimin per ndonje nga drejtor, menaxher. AK-ja eshte dashur qe operatorin ta shpall te papergjegjshem dhe te vazhdoj me operator tjer te ranguar 2, 3 dhe me ralle.

Ne ARBK si dhe ne informatorin e biznesit keta persona jane pronar/aksionar, drejtor ekzekutiv:

1.Drejtor ekzekutiv: Driton Zairi

2.Rimon Ben Shaoul – Antar I bordit – Drejtor

3.Shay Livnat - Antar I bordit – Drejtor

4.Shaul Ben xeev - Antar I bordit – Drejtor

5.Abraham Teboul - Antar I bordit – Drejtor

6.Ken Eliahou Lalo - Antar I bordit – Drejtor

Per te gjithe personat e lartpermendur nuk eshte dorzuar vertetim nga gjykate sipas dosjes se tenderit qe personat ne fjale nuk jane shpallur fajtor nga ndonje gjykate ne dhjete (10) vitet e fundit.

Konkluzion:

Ne baze te pikave te lartpermendura ne kerkojm qe te behet rishqyrtimi i vendimit per shperblim me kontrate, operatorin e propozuar per kontrate ta cilesoj si te papergjegjshem dhe ne baze te fakteve te prezentuar te verifikohen dyshimet peri mashtrim dhe falsifikim,operatori te diskualifikohet dhe te vazhdoj me operator tjer te ranguar 2, 3 dhe me ralle.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga httpkrpp.rksgov.net.

Dështmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit.

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues

para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë, 2. Certifikata e numrit fiskal.

Dështmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e Certifikatës se biznesit, 2. Kopja e Certifikatës se numrit fiskal.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 3,000,000.00 €.

Dështmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka furnizuar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose të ngjajshme me vlere minimale prej 2,000,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit,duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë.

2. OE duhet te dorezoj nje autorizim nga prodhuesit të mjetit bazë (ose përfaqësuesit tëautorizuar).

3. OE duhet te dorezoj nje vërtetim te karakteristikave teknike të kërkuara të mjetit (shasisë).

4. OE duhet te dorezoj nje autorizim apo konfirmimi i prodhuesit të superstrukturës.

5. OE duhet te dorezoj nje vërtetim i karakteristikave teknike të kërkuara të superstrukturës.

6. OE duhet te dorezoj nje Certifikatë të vlefshme për prodhuesin e superstrukturës për

përmbushjen e kërkesave të ISO 9001 2015 (ose standarde kombëtare ekuivalente) ose më të reja, të lëshuara nga institucione të akredituara.

7. OE duhet te dorezoj nje certifikatë te vlefshme për prodhuesin e superstrukturës mbi përmbushjen e kërkesave të standardit EN ISO 3834-2 (ose standardit kombëtar ekuivalent), të lëshuar nga një institucion i akredituar.

8. OE duhet te dorezoj nje Certifikate të vlefshme për testimin e kualifikimit të saldatorëve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017 (ose standardit kombëtar ekuivalent), për të paktën 5 saldatorë të punësuar nga prodhuesit e superstrukturave me dëshmi punësimi.

9. OE duhet te dorezoj një kopje të certifikatës HARDOX në trupin tim të lëshuar nga prodhuesi i HARDOX tek prodhuesi i superstrukturës.

10. OE duhet te dorezoj nje vizatim teknik te mjetit të plotë të ofruar të lëshuar nga prodhuesi i superstrukturës nga i cili mund të përcaktohet qartë plotësimi i kërkesave teknike.

11. OE duhet te dorezoj të gjitha superstrukturat e ofruara të punuara nga i njëjti prodhues.

12. T ë gjitha automjetet e ofruara (shasi) të prodhuara nga i njëjti prodhues.

13. OE duhet te dorezoj Katalogun e shasisë.

14. OE duhet te dorezoj Katalogun e superstrukturës – mbindërtimit.

15. OE duhet te ofroj Garancion për shasi dhe mbindërtim minimum 1 vit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

2. Dëshmia Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi për mjetin bazë me numër të prokurimit publik për këtë procedurë.

3. Vërtetim i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i mjetit (shasisë), me numër të prokurimit publik dhe modelit të mjetit bazëshasi të ofruar.

4. Autorizimi që përmban sherbimet e dizajnimit, zhvillimimit, prodhimit, shitjes dhe shërbimi pas shitjes të automjeteve dhe pajisjeve komunale.

5. Vërtetim i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i superstrukturës, me numër të prokurimit

publik dhe modelit të superstrukturës së ofruar.

6. Kopje Certifikata ISO 9001 2015 me afat te vlefshmerise.

7. Kopje e Certifikates EN ISO 3834-2 me afat te vlefshmerise.

8. Kopje e Certifikates (me dëshmi punësimi) për testimin e kualifikimit të saldatorëve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017.

9. Kopje e certifikatës që përmban dëshminë e përdorimit të pllakave mveshëse origjinale.

10. Vizatimi teknik i lëshuar nga prodhuesi për superstrukturë.

11. Deklaratë nga prodhuesi se të gjitha superstrukturat prodhohen nga i njëjti.

12. Deklaratë nga prodhuesi se të gjitha automjetet e ofruara (shasi) prodhohen nga injëjti.

13. Katalogu i nenshruar dhe i vulosur.

14. Katalogu i nenshruar dhe i vulosur.

15. Kopje Garancioni 1 vit për shasi dhe mbindërtim.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vleresimit gjate vleresimit te ofertave konstatoj se per kete projekt , ofertat e tyre i kane dorezuar katër OE, N. P.T. Komisioni konstatoj se oferta e dorezuar nga OE " VIBTIS " D NË KOSOVËN. P.T. eshte e papergjegjshem per shkak se nuk i ka plotesuar kriterin teknik per kontratat e pefunduara ne tri vitet e fundit ne vlere minimale prej 2,000.000.00€, (ka realizuar k ne vlere prej 1,903.196.70€), Ndersa, OE Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.I PORTOFIN d.o.o., eshte e pergjegjshme por, nuk ka ofertuar me çmimin me te lire. OE N. P.T " Haxhijaha" eshte e pergjegjshme por, nuk ka ofertuar me çmimin me te lire. Andaj, komisioni vendosi qe me kontrate per „Furnizim me pajisje per pastrimin e kryeqytetit ", te REKOMADO. OE Grup i Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; KOSOVA MOTORS J.S.C. eshte ofe i pergjegjshem me çmimin me te lire ne vlere prej 1,250,800.00 EUR.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k.**

Përgjigje ne pretendimin nr. 1

Pretendimi i pare ankimore nga OE ankuese "Haxhi Jaha" shpk, ka te beje me dorëzimin e ofertës ne emër te anëtarit te grupit OE "Kosova Motors" J.S.C, ku pretendohet se oferta

eshtë dorëzuar nga personi i pa autorizuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK – Komuna Prishtine, përgjatë vlerësimit te ofertave bazuar ne nenin 59 dhe 72, te LPP-se ka kërkuar sqarime shtese nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës dhe përmes përgjigjes ne kërkese grupi i OE-ve "D & T Group" & "Kosova Motors" J.S.C, kane prezantuar autorizimin për Përfaqësim te formes noteriale te datës 11.07.2017, me nr. rendore LRP 5095/2017, ku ne te njëjtin eshtë autorizuar z. Valdrin Manaj, qe ne emër te z. Driton Zairi, drejtor ekzekutiv, ne kompaninë "Kosova Motors" JSC, qe ne emër tije te përfaqësoj dhe te ndërmarr te gjitha veprimet e nevojshme për cilën do pune, pranë institucioneve te Republikës se Kosovës, përfshire shitjen, lidhjen e kontratave dorëzimin dhe negocimin e ofertave etj, prandaj ketë pretendim ankimore e vlerësojmë si te pa bazuar. Si prove ne e prokurimin mund ta gjeni Autorizimin për përfaqësim te datës 11.07.2017.

Përgjigje ne pretendimin nr. 2

Pretendimi ankimore tjetër qe ndërlidhet me kërkesën e përcaktuar ne piken 9.1 & 9.2, pika 4 te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional lidhur me Autorizimin e Superstrukturës.

Sipas dëshmisë dokumentare është kërkuar qe Autorizimi te përmbaje shërbimet e dizajnit, zhvillimit, prodhimit shitjes dhe shërbimit pas shitjes se automjeteve dhe pajisjeve.

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës OE "D &T Group" shpk & "Kosova Motors JSC", kane prezantuar ne oferte Autorizimin e Prodhuesit te Superstrukturës "Kartmerciler", ku janë prezantuar disa Autorizime ndaras për ofertim te produktit, sistem te superstrukturës dhe garancinë te superstrukturës.

Ne deklaratat e prodhuesit te superstrukturës se datës. 01.09.2023, prodhuesi "Kartmerciler", konfirmohet se karakteristikat teknike te superstrukturës siç janë paraqitur ne katalogun tone përputhen dhe përmbushin te gjitha specifikat teknike te paraqitura nga ne në dosjen e tenderit.

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës për ketë procedurë te prokurimit ne oferte ka paraqitur edhe katalogët e te njëjtit prodhues ku janë te përcaktuara edhe shërbimet e dizajnit dhe pajisjeve komunale tjera te përcaktuara nga AK – Komuna Prishtine .

Përgjigje ne pretendimin nr. 3

Pretendimi tjetër ankimore qe ka te beje me pozicionin 5, te pikës 9.1 & 9.2 te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional, "OE duhet te dorëzoj një vërtetim te karakteristikave teknike te superstrukturës" – Dëshmia "Vërtetim i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i superstrukturës me numër te prokurimit dhe modelit te superstrukturës se ofruar.

Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës ne oferte ka prezantuar dëshmi përmes te cilave konfirmohet se mbulohet kërkesa e kualifikimit.

Ne Autorizimin e Prodhuesit te superstrukturës, përfshire edhe katalogët e te njëjtit

prodhues te dorëzuara ne oferte, janë te përcaktuara karakteristikat teknike te superstrukturës. Ne Autorizimet e prodhuesit "Kartmerciler", konfirmon se modelet e superstrukturës te listuara dhe te përshkruara ne oferta tona për prokurimin ne fjale janë duke përfshire specifikimet teknike dhe veçorit qe kemi ofruar, janë prodhuar nga "Katmerciler Arac..". Te njëjtat modele janë prodhuar, projektuar duke zhvilluar eksperience dhe aftësi inxhinierike dhe standarde te rrepta inxhinierike.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës e plotësojnë ketë kërkese te dosjes se tenderit, ku janë prezantuar dështmitë vërtetimet te firmosura dhe te nënshkruara nga prodhuesi i superstrukturës. Si prove ne ofertën e grupit te OE-ve te propozuar për dhënie te kontratës i gjeni dështmitë – Autorizimet – konfirmimet dhe katalogët e superstrukturës.

Përgjigje ne pretendimin nr. 4

Pretendimi ankimore lidhur me pozicionin 8, te pikës 9.1 & 9.2, te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional, ku AK -Komuna Prishtine ka kërkuar: 5 saldatore te punësuar nga prodhuesi, përkatësisht certifikata te vlefshme për testimin e kualifikimit te saldatoreve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017, ose standardin kombëtar ekuivalent.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne vlerësimin fillestar te ofertave, pikërisht për ketë qeshje i njëjti OE ishte eliminuar si i pa përgjegjshëm, përkundër faktit se sipas përgjigjes se datës 24.10.2023 grupi i OE-ve te "D &T Group shpk & Kosova Motors J.S.C", certifikatat e saldatoreve me validitet deri me datën 03.06.2024, sipas standardeve te kërkuara, ne sqarimin e dhëne nga "G&T Group" SHPK, përkundër faktit se vet prodhuesi me deklaratë ka potencuar se te njëjtat certifikime janë konfidenciale. Si prove te njëjtat certifikime mund ti gjeni ne e-prokurim me validitet dhe sipas standardit.

Kjo qeshje sipas kundërshtimit te vlerësimit fillestar te ofertave sipas kërkesës për ri shqyrtim te Grupit te OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës eshtë aprovuar nga AK – Komuna Prishtine me vendim dhe lënda eshtë kthyer ne rivlerësim. Si prove kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin AK – Komuna Prishtine e gjeni ne e-prokurim.

Përgjigje ne pretendimin nr. 5

Pretendimi ankimore i fundit ka te bëjmë me pozicionin 13, te pikës 9.1 & 9.2 te FDT-se, ku eshtë kërkuar "Katalog i shastise i nënshkruar dhe vulosur.

Operatori ekonomik ankues ne ankese pretendon se katalogu i ngarkuar ne oferte nga grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës ne emër te prodhuesit "Ford Trucks" për modelin "Ford TRUCKS 1833 DC Euro 6", për pozicione te caktuara ka ndryshime nga katalogët e prodhuesit te publikuar ne ueb faqe, siç është pozicioni "Wheelbase", ku ne katalogun e OE te rekomanduar përshkruhet vlera prej 3400 mm, ndërsa ne ueb faqe për te njëjtin produkt përshkruhet vlera 3360mm. Pozicioni "Technicaly permissible maximum mass on front axle" ne katalogun e prezantuar ne oferte eshtë përshkruar vlera prej 4000 kg, ndërsa ne katalogun e publikuar ne ueb faqen e prodhuesit përshkruhet vlera prej 3000 kg.

OE ankues konteston edhe pozicione tjera sipas ankesës.

Eksperti shqyrtues, ka ekzaminuar dhe ka krahasuar dimensionet e produktit "Ford TRUCKS 1833 DC Euro 6", dhe ka rezultuar qe ne katalogun e publikuar ne uebfaqen e prodhuesit dimensionet për te njëjtin produkt ndryshojnë nga katalogu i prezantuar ne oferte pikërisht për te njëjtin produkt. Megjithatë eksperti shqyrtues sqaron se AK – Komuna Prishtine, zyra e prokurimit, me daten 08.09.2023, perkës Emilit ka kërkuar nga prodhuesi, konfirmim te katalogut dhe konfirmim te përmbajtjes se te njëjtit katalog ne kuptim te saktësi se tije.

Po te njëjtën dite, zyra e prokurimit te AK – Komuna Prishtine, pranon konfirmim, ku prodhuesi deklarohet se: Te dhënat ne prospekt – katalog te dorëzuar nga D &T Group & Kosova Motors J.S.C, janë te sakta nga fabrika dhe janë te njëjta ne automjet te cilat do ti dorëzohen autoritetit kontraktues. Si prove mund ta gjeni kërkesën për konfirmim dhe konfirmimin e datës 08.09.2023.

Kërkesa:

From: Prokurimi Prishtine <
Sent: Wednesday, November 8, 2023 3:49 PM
To: office@ford.com.al
Cc: Visar Shehu
Subject: Request for clarification

Dear Sirs,

We, the contracting authority, the Municipality of Prishtina, are in the evaluation phase of the tender entitled: "Supply of equipment for the cleaning of the capital" and according to the authorizations, you are an authorized dealer of the manufacturer and we need you to confirm the catalog offered by the company D & T Group SH.P.K. & Kosova Motors J.S.C. SHA in this tender and confirm its content to us if it is correct.

Since we are evaluating the offers, we would appreciate a quick response from you.

Konfirmimi:

From: jozef mirdita <jozef.mirdita@ford.com.al>
Sent: Wednesday, November 8, 2023 16:06
To: Prokurimi Prishtine; Visar Shehu
Cc: 'Ford Albania'
Subject: RE: Request for clarification

Dear All

Here with we declare that: All data in prospect, delivered in tender from D&T Group & Kosova Motors J.S.C. ShA, are correct inserted from factory, and are the same in vehicle which will be delivered to contracting authority.

Thank you and
Best regards,

Jozef MIRDITA
Ford Brand Manager

Albania Motor Company shpk

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k.**

Burim Guri